



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

TERMA REFERENCE

PËR OBJEKTIN :

“Studim Projektim i rrugës Kardhiq – Delvinë, Sinjalistika (Loti 8) ”

“Studim Projektim i rrugës lidhëse Shijan – Ura e Gajdarit, rehabilitimi i segmentit Shijan – Delvinë“ dhe “Mbrojtja dhe rivitalizimi i skarpatave”

TË PËRGJITHSHME

Me fonde të buxhetit të shtetit për vitin 2020, janë planifikuar objektet :

- 1.“ SP i rrugës Kardhiq – Delvinë, Sinjalistika (Loti 8)
- 2.“SP i rrugës lidhëse Shijan – Ura e Gajdarit, rehabilitimi i segmentit Shijan – Delvinë”
3. “SP Mbrojtja dhe rivitalizimi i skarpatave”

I. PËRSHKRIMI NË TERREN I GJURMËS EKZISTUESE

Aksi rrugor Kardhiq - Delvinë ka një gjatësi prej 33 km dhe është i ndarë në 7 lote, loti i 7 i të cilit ka parashikuar ndërtimin e tunelit. Loti 8 parashikon ndërtimin e sinjalistikës dhe elementëve të sigurisë rrugore për 6 lote, duke përjashtuar lotin 7 të tunelit, projekti i sinjalistikës së të cilit është specifik dhe përfshihet në projektin e ndërtimit të tij.

Ndarja në lot-e është si më poshtë :

Loti 1

Ky Lot fillon nga kryqëzimi pranë urës së Kardhiqit në aksin rrugor Tepelenë – Gjirokastrë dhe ka një gjatësi prej 7+124.29 km. i cili tashmë është i përfunduar por pa sinjalistikën dhe elementët e sigurisë rrugore (foto 1.2)



(foto 1.2)

Loti 2

Edhe Loti 2 me gjatësi 4.399 km është i përfunduar dhe pa elementët e sinjalistikës dhe të sigurisë rrugore. (foto 3).






(foto 3)

Loti 3

Loti 3 ka një gjatësi prej 4.98km dhe është i përfunduar dhe pa sinjalistikën horizontale dhe vertikale dhe elementët e sigurisë rrugore. (foto 4)



(foto 4)

Loti 4 – fillon në pikën fundore të Lotit 1 (Km. 7+124.79) i zbatuar, të ketij projekti, në afërsi të kryqëzimit me fshatin Fushë Bardhë dhe përfundon në afërsi të Qafës së Skërficës në Km 6+762.05 .

Gjatësia e Loti 4 është 6.762 km. Terreni që pëshkon ky Lot është kodrinor - malor dhe në përgjithësi seksoni terthor i rrugës është në gjërmim. Aktualisht është në fazën e zbatimit të kontratës së ndërtimit të rrugës(foto 5)



(foto 5)

Në këtë segment rrugor parashikohen të ndërtohen vepra arti të vogla si dhe të mëdha - 3 ura.

Loti 5 – fillon në pikën fundore të Lotit 6 (Km. 13+151.69), të këtij projekti, dhe përfundon në Km 16+209.76, që korespondon në pikën fundore të Lotit 3, i zbatuar.

Gjatësia e Loti 5 është 3.058 km. Terreni që përshkon ky Lot është terren kodrinor e malor. Në përgjithësi seksoni tërthor i rrugës është në gjërmim, dhe aktualisht po vijon puna sipas kontratës së ndërtimit.

Loti 6 – (Km 8+288.21 – Km 13+151.69) **fillon në** pikën fundore të Lotit 7, të këtij projekti dhe përfundon në Km 13+151.69 të fillimit të Lotit 5.

Gjatësia e Loti 6 është 4.863 km. Terreni që përshkon ky Lot është kodrinor dhe malor. Në përgjithësi seksoni tërthor i rrugës është në gjërmim dhe aktualisht është në procesin e ndërtimit të tij

Loti 7 –Tuneli , fillon mbas lotit 4 dhe e lidh me Lotin 6. Aktualisht ky lot është në fazën e hartimit të projektit, ku përfshihet dhe sinjalistika e tunelit.

Aktualisht pranë ARRSH-së është një projekt i hartuar në vitin 2010. Për të rritur sigurinë rrugore dhe përshtatjen e projektit ekzistues me parametrat e rinj të sigurisë , del e nevojshme rishikimi i tij duke e plotësuar atë me të gjithë elementët e rinj si në sinjalistikën horizontale, vertikale dhe me pajisjet e sigurisë rrugore.

II. QËLLIMI I PUNËS

Qëllimi i këtyre Termave të Referencës është hartimi i projektit të sinjalistikës së rrugës Kardhiq – Delvinë, duke përjashtuar sinjalistikën e Lot 7 të tunelit , studim projektimi i rrugës lidhëse Shijan – Ura e Gajdarit dhe rehabilitimin e rrugës lidhëse Shijan – Delvinë si dhe, studim projektim mbrojtja e rivitalizimi skarpave për lot^{et} 1-6. Gjithashtu për kryqëzimin e Shijanit, të parashikohet realizimi i ndricimit si nyje shumë e rëndësishme ku trafiku është i një numri të lartë dhe në kushte të errësirës mund të ketë probleme me shikueshmërinë.

Detyra e kontraktorit është rishikimi i projektit të sinjalistikës të hartuar në vitin 2009, adoptimi i tij me standartet e reja të sigurisë, hartimi i një projekti të detajuar të zbatimit i cili do të përfshijë të gjitha masat për sinjalistikën dhe sigurinë rrugore në këtë aks, në zbatim të Kodit Rrugor të RSH, Rregullores në zbatim të këtij kodi, Manualit të Sinjalistikës dhe standarteve shqiptare apo ndërkombëtare, si dhe eksperiencave më të mira të vendit tonë në këtë drejtim.

III. OBJEKTIVAT E TERMAVE TË REFERENCËS

Konsulenti duhet;

1. Për sinjalistikë e siguri rrugore

- **Konsulenti duhet të studiojë dhe të marrë në konsideratë** projektin e hartuar në vitin 2009, si dhe çdo projekt apo studim të mëparshëm që kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugës, për akset të cilat janë në proces ndërtimi, si dhe ato të përfunduara.
- **Të jetë në koherencë të vazhdueshme** me të gjitha ndryshimet e mundëshme që mund të ndodhin në akset të cilat janë në proces ndërtimi (Loti 4.5.6) duke i reflektuar ato në hartimin e projektit të ri të sinjalistikës,
- **Ai duhet të mbështetet dhe të zbatojë** legjislacionin shqiptar për këtë qëllim.

Konsulenti duhet të mbështetet në standartet shqiptare në fuqi (të vitit 2015) dhe standarteve europiane të miratuara dhe të përditësuara për këto ndërtime dhe kategori rruge.

- **Të përcaktojë sasinë e përafërta të punimeve**, zërat e mundshëm të punimeve dhe çmimet orientuese për të realizuar një preventiv paraprak.

2. Studim Projektimi i rrugëve lidhëse Shijan – Ura e Gajdarit, rehabilitimi i segmentit rrugor Shijan – Delvinë “

- Vënja në eficientë të plotë e të gjithë aksit rrugor Kardhiq – Delvinë dhe lidhja me qytetin e Sarandës dhe Delvinës, me qëllim shkurtimin e kohës së lëvizjes së trafikut dhe krijimit të një sigurie dhe komoditeti për të gjithë përdoruesit e rrugës.
- Gjithashtu trajtimi i nyjes së hyrjes së rrugës Kardhiq – Delvinë (km 0+000) në kryqëzim me aksin rrugor kombëtar Gjirokastër Kakavijë.



IV . KËRKESAT PËR PROJEKTIN

1.Për sinjalistikën

Konsulenti nëpërmjet hartimit të projektit të zbatimit duhet të ketë parasysh që rrugët të jenë të pajisura me sinjalistikën e duhur vertikale e horizontale me qëllim që të jenë sa më “vetshpjeguese” e cila mund të “lexohet” lehtë nga ana e të gjithë përdoruesve të rrugës që të mos ndodhen përpara të papriturave që ofron një segment me mangësi në këtë drejtim.

Për të qenë sa më efektive , sinjalistika horizontale dhe vertikale, duhet të jetë

- lehtësisht e lexueshme;
- të përcjellë mesazhe të cilat mund të kuptohen shpejt;
- të jenë të bashkërenduara me planin gjeometrik të rrugës
- të jenë të spikatur ditën dhe natën;
- të vendosen mjaft larg përpara situatave për të dhënë kohë të mjaftueshme për përdoruesit e rrugës me qëllim ndërmarren e veprimeve të duhura

1.. Trajtimi me sinjalistikën e nyjes hyrëse e (kryqëzimi pranë urës së Kardhiqit në aksin Tepelenë – Gjirokastër). Duke patur parasysh rëndësinë që përben kjo nyje, në ndarjen e trafikut për drejtimet Tepelenë – Gjirokastër e Kardhiq – Delvinë, nga ana e Konsulentit duhet të tregohet kujdes në projektimin e sinjalistikës vertikale me tabelat e emërtimeve të drejtimit për qytetet/fshatrat, sinjalistikën horizontale me shigjetat e lëvizjes për kthimet majtas e djathtas, sigurimin e akseseve për vendkalimet e kembësorëve, përdorimin e sy maceve me qëllim që të jetë sa më e dukshme në kushtet e errësirës, trajtimin e ishujve të trafikut e tjerë.

2.Në zonat urbane të përcaktohen qartë sinjalistika dhe trajtimi i tyre sipas standarteve. Në këto zona të merret në konsideratë kalimet e këmbësorëve, pajisja me sinjalistikën e duhur të hyrje – daljeve me qëllim sigurimin e tyre. Prezencën e sinjalistikës së duhur pranë shkollave apo institucioneve të tjera ku numri i lëvizjes së këmbësorëve është më i madh.

Të përcaktohet qartë me tabela emërtuese, dhe të paralajmërohet hyrja në zonën e banuar, me sinjalistikën e duhur për kufizim të shpejtësisë, me tabelat detyruese të ndalim parakalimit e tjerë.

Të trajtohen me kujdes xhepat e lënë me qëllim stacion ndalese/pushimi për urbanët furgonët e tjerë.

Lajmërimi I tyre për vendodhjen të bëhet në distancat e caktuara, duke vendosur edhe tabelat për reduktim shpejtësie sipas normave të lejuara.

3.Kryqëzimet në nivel - nga ana e projektuesit të kihet parasysh:

■ Realizimin e sinjalistikës se kryqëzimeve me qëllim që të jenë sa më të dukshme nga ana e drejtuesve të mjeteve, nëpërmjet plotësimit të saktë me sinjalistikën vertikale, me atë horizontale, me elementë shtesë që paralajmërojnë afrimin në kryqëzim si shiritat e zhurmës, symacet apo realizimet në forma tjerave të ngadaksuesve të shpejtësisë. Kujdes të tregohet në rakordimin e sinjalistikës horizontale me ato vertikale.



- Të realizohen kushtet e përshtatëshme për shikueshmëri maksimale në kushtet kur pranë kryqëzimeve ka objekte të cilat mund të jenë pengesë siç janë shtëpitë, kioskat, shkurret/vegjetacion mbi normat e lejuara e tjerë.
- Aty ku ekziston mundësia të bëhet realizimi i korsisë së kthimit majtas, nga rruga kryesore
- Në çdo kryqëzim të realizohet siguria për kalimin e këmbësorëve.



4. Ishujt e trafikut

Të trajtohen me sinjalistikën e duhur vertikale. Në këndet e tyre që janë përballë drejtimit të lëvizjes, të vendosen mbrojtëse/terminale të shoqëruara me tabelën e drejtimit të detyruar, me qëllim shmangjen e përplasjes me bordurën e ishullit.

Kanalizimi i lëvizjes nëpërmjet shigjetave të sinjalitikës horizontale.



5.Hyrje – Daljet, si një nga vendet ku dhe janë shkak për ndodhjen e aksidenteve rrugorë, të kihet parasysh :



- Te trajtohen të gjitha hyrje – daljet me sinjalistikën e duhur vertikale dhe horizontale.
- Të gjitha akseset në rrugën kryesore duhet të jenë në përputhje me kategorinë e rrugës dhe standartet e projekteve.

6. Emërtimet e vendeve - Konsulenti duhet të ketë parasysh vendosjen e tabelave sipas standartit për emërtimet e fshatrave, rrugëve të aksesit, vendeve historike, vendeve turistike, vendeve të kulteve fetare e tjerë.

7. Trajtimi me sinjalistikë i kthesave dhe pjesëve të rrugës që kalojnë në terren kodrinor e malor – Konsulenti duhet të bëjë kujdes me pajisjen me sinjalistikën e duhur për kthesat me qëllim që të jenë të paralajmëruara dukshëm edhe në kushtet e errësirës, të trajtoje vendet ku rruga ka pendencë me tabelat paralajmëruese, vendet ku ka rrezik për rënje materiale nga shpatet e maleve, e tjerë.

8. Mbrojtëset anësore metalike /guardrelet

Duke qënë rrugë, pjesërisht në terren kodrinor e malor, të parashikohet vendosja e tyre në kthesat e rrezikshme dhe në terrenet ku lartësia e rrugës nga vija e tokës e kërkon si domosdoshmëri.

Ne mënyrë të vecantë :

- Barrierat anësore metalike duhet të parashikohen të jenë sipas Rregullit Teknik të Projektimit të Rrugëve (2015) dhe sipas Eurokodit EN-1317
- Të studiohet tipi dhe pozicioni i vendosjes së tyre duke marrë, përmiresuar dhe krahasuar me projektin fillestar
- Të kihet parasysh detajet e fundoreve të guardreleve (të shmangen ato bisht peshk.). të parashikohen me detaj të përcaktuar qartë ngulja e tyre në tokë me kënd me aksin e rrugës .
- Të studiohen mirë guardrielet (tipi i tyre) që do të vendosen në hyrje apo dalje të tunelit, gjatë zonës tunelore, duke patur parasysh sigurinë rrugore dhe standartet në fuqi.
- Të paraqiten detajet e bashkimit të mbrojtëseve metalike të rrugës me ato të urave.



9. Tabelat e sinjalistikës vertikale do të jenë bazuar në Manualin Shqiptar të Projektimit të Rrugëve (MSHPRR 6 Kapitulli 1), Kodit Rrugor, Rregullores në zbatim të tij dhe Manualit të Sinjalizimit.

10. Vijëzimet/ Sinjalistika horizontale

Vijëzimet duhet të jenë të parashikuara me material termoplastik që përputhet me kërkesat e EN 1871: 2000. Këto kërkesa japin këto avantazhe :

- Performanca të lartë shikueshmërie ditën e natën dhe një reflektim të qëndrueshëm.
- Tharje e shpejte, duke paraqitur kështu rezistence të mirë të rrjedhjes.
- Ngjitje perfekte
- Qëndrueshmëri e lartë
- Rezistenca e mirë e rrëshqitjes
- Jo-toksike dhe mjedisore
- Duke patur parasysh qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë vlera në para që planifikohet për to, është ekonomike.

Është vërtetuar se përdorimi i materialit vijëzues rrugor termoplastik mund të reduktojë mbi 25% të aksidenteve duke përmirësuar kështu performancën e vijëzimeve rrugore.

Konsulenti duhet të tregojë kujdes në projektimin e saktë të vijëzimeve me qëllim përputhjen e tyre me sinjalistikën vertikale.

Konsulenti duhet të ketë parasysh që:

- Të mos përfshijë sinjalistikën e pjesës së tunelit i cili ka specifika të veçanta.
- Të shfrytëzojë të gjitha materialet (projektin aktual) dhe të jetë në koherencë me të gjitha ndryshimet e mundëshme të segmenteve aktuale që janë në ndërtim, duke i pasqyruar ato në projektin final të tij.
- Të ketë në konsideratë të gjitha informacionet e mundëshme të cilat do të shërbejnë për ta pasuruar dhe më shumë projektin e sinjalistikës.
-

Per segmentet rrugore “ rrugës lidhëse Shijan – Ura e Gajdarit, Rehabilitimi I segmentit rrugor Shijan – Delvinë “

I PËRSHKRIMI

Rruga Kardhiq – Delvinë ka një gjatësi 33 km dhe shtrihet në Jug të Shqipërisë, përshkon rrethin e Gjirokastrës, Delvinës dhe Sarandës. Në këtë aks janë përfunduar rreth 16 km rrugë dhe 16 km të tjerë janë në fazën e zbatimit të punimeve. Pjesa e mbetur prej 16 km ndahet në lotet 4.5.6.7.8, nga të cilat loti 7 dhe loti 8 janë Tuneli (Loti 7) dhe sinjalistika e përgjithshme për 32Km (loti 8)

- Segmenti rrugor Shijan – Ura e Gajdarit

Ky segment fillon në rrethrotullimin e fshatit Shijan km 0+000 dhe përfundon në rrethrotullimin e urës së Gajdarit km 5+700. Ku bëhet lidhja me fshatin Jergucat – Sarandë



në rrethrotullimin e fshatit Shijan ka filluar dhe Loti 2 I rrugës Kardhiq – Delvinë I cili ka përfunduar. Segmenti rrugor me gjatësi 5.7 km kalon pothuajse në një terren fushor. Gjerësia e rrugës ekzistuese varion nga 5.5 – 6m. Kthesat nuk I përgjigjen standartit C 2 të kushteve të reja të projektimit. Shtresat rrugore janë në gjëndje relativisht të mire. Parametrat e këtij segmenti do të jenë sipas kategorisë C 2 të kushteve teknike të projektimit të vitit 2015

- Kategoria e rrugës 11m
- Pjesa kaluese 2*3.5m + 2*1.25m
- Bankina të paasfaltuara 2*0.75m

I gjithë aksi rrugor i rrugës Kardhiq – Delvinë është projektuar sipas këtyre parametrave.

- Rehabilitimi i segmentit rrugor Shijan – Delvinë

Ky segment rrugor fillon në rrethrotullimin e fshatit Shijan km 0+000 dhe përfundon në qytetin e Delvinës km 6+800. Gjerësia e rrugës është 5.5 – 6m. Shtresat asfaltike në pjesë të veçanta janë të dëmtuara. Projektimi për rehabilitimin e këtij segmenti do bëhet duke ruajtur gjurmën ekzistuese.

3. Studim Projektimi Mbrojtja dhe rivitalizimi i skarpatave

Rilevimi gjeologjik në terren Kardhiq –Delvine Loti 4-5-6-1.

1. Kushtet gjeologo-inxhinierike te rruges Kardhiq-Delvine loti 4.

Nga kilometri 0+000 e deri 0+850 (te Lotit 4) traseja e rrugës kalon në depozitimet aluvionale të lumit. Janë suargjila te lehta deri të mesme me ngjyrë bezhe deri në gri, janë me lagështire dhe mesatarisht të ngjeshura.

Këto dhera janë pak të qëndrueshme për shkak të përbërjes të tyre. Gjithashtu ujrat sipërfaqësore përbëjnë problem pasi shkaktojnë një erozion të fuqishëm ashtu sic duket në foto dhe rrezikojnë krijimin e çarjeve duke rritur rrezikun e shëmbjeve.

Nga vërtetimet ne terren, skarpatat me ndertim argjilor, flishor dhe suargjilash cakëllore pak te ngjeshura, në ngjyre kafe, me lartesi nga rruga deri ne 2 meter. Edhe këto dhera janë të paqëndrueshme nga gërryerjet e ujrave sipërfaqësorë. (foto 1, 2)



Foto 1



Foto 2

Me tej deri Km 2+920 (te Lotit 4) traseja e rrugës kalon në depozitimet evaporitike që përfaqësohen nga gipse, anhidrite, dolomite, kripte guri, etj. Në sipërfaqe, në shumicën e rasteve mbulohen nga kësula e gurtë (keproku) , e cila në vetvete përbehet nga përzierje gëlqerorësh, dolomite, ranore, anhidride dhe gipse në trajte brekçore. (foto 3)



Foto 3

Këto formacione janë të qëndrueshme në përgjithësi por gjithsesi, kërkohet një masë mbrojtëse nga ujrat sipërfaqësore për të shmangur rrëzimet e materialeve të imta.

Më tej deri në km 6+615 traseja e rrugës kalon në depozitimet gëlqerore të Kretakut. Këta shkëmbinj janë me ngjyrë gri deri të bardhë dhe janë pak të përjarruar dhe te karstezuar në sipërfaqe. (foto 4, 5)



Foto 4



Foto 5

Këto formacione janë shumë të qëndrueshme si për shkak të llojit por edhe për shkak të shtrirjes të tyre ëe anën e kundërt të aksit të rrugës. Kushtet atmosferike ndikojnë pak në këta lloje shkëmbinjsh dhe për këtë arsye mund të nevojitet vetëm një mbrojtje nga rënia me raste e ndonjë materiali inert si (guralece te vegjel).

2. Kushtet gjeologo-inxhinjerieke të rrugës Kardhiq-Delvine. Loti 5.

Nga kilometri 13+150 deri 14+300 traseja e rruges kalon në depozitimet gëlqerore të Eocenit. Përbëhet nga gëlqerore turbiditike, që gradualisht ja lënë vendin gëlqeroreve shtresorë biomikritike e mikritike, me permbajtje argjilash mergelore të cilat në pjesën më të sipërme predominojnë duke kaluar në mergelet e “pakos kalimtare”. (foto 6, 7)



Foto 6



Foto 7

Këto formacione janë të qëndrueshme dhe nuk paraqesin rrezikshmëri shembje në skarpatat e këtij **Loti**. Masa te lehta mbrojtëse, nevojiten në këtë pjesë të aksit rrugor për mbrojtjen nga rënia e copave të vogla shkëmbore.

Më tej deri në km 16 + 535 traseja e rrugës kalon ne depozitimet flishore të Oligocenit Poshtëm. Përbëhen nga ndërthurje shtresash argjilo-alevroliti dhe ranori me ngjyrë bezhë deri në gri. Nga shpatet e pjerta në luginën e thellë mbi këta shkëmbinj vendosen depozitime deluvjale me trashësi që varion nga 0.0 deri në rreth 2.0 metra.

Në këtë pjesë të aksit vërejmë disa shëmbje të skarpatave për shkak të gërryerjes nga ujrat sipërfaqësore.



Foto 8a



Foto 8b



Foto 9 (ana lindore)



Foto 10 (ana perendimore e Usekut)



Në kilometrin 16+175 deri në 16+375 vërejmë argjila kafe të përziera me argjilite të përjruar dhe në disa vënde edhe shtresa zhavori me trashësi 40 cm. Në këtë aks skarpatat janë nga 2 m lartësi deri në 7 m. (foto 11a,11b)



Foto 11a



Foto 11b

3. Kushtet gjeologo-inxhinierike të rrugës Kardhiq-Delvinë loti 6.

Nga kilometri 8+200 e deri ne kilometrin 12+825 traseja e rruges kalon në depozitimet gëlqerore. Ne këto formacione, nga vrojtimet në terren, nuk vërehen shëmbje të skarpatave për shkak të fortësisë së shkëmbinjve karbonatik dhe shtrirjes të shtresave në drejtim relievit të shpatit. (foto 12)



Foto 12

Më tej 12+825 deri në km 12+950 traseja e rrugës kalon në depozitimet flishore të përbëra nga ndërthurje shtresash argjiliti-alevroliti dhe ranori me ngjyrë bezhë deri në gri. Janë me pak lagështirë dhe të ngeshur mirë. Këta janë formacione gjysëm shkëmbore dhe janë mjaft të perajrueshëm. (foto 13)



Foto 13

Më tej deri në km 13+150 traseja e rrugës kalon në depozitimet gëlqerore të Paleocenit. (foto 14)



Foto 14

Ne segmentin 12+800 km deri në 12+975 km (krahu jugor i aksit të rruëes) vërejmë një rrëshkitje të bermave pasi kemi formacione me flishe të përjarruar dhe argjila cakellore te cilat

janë të paqëndrueshme dhe takohen në bërmat e poshtme të skarpatës. Në segmentin 10+630 km deri në 10+665 km (krahu verior i aksit të rrugës) vërejmë një shkëputje për shkak të shkëmbinjve karbonatik me carshmeri të lartë. Carjet në këta shkëmbinj janë me material argjilor të kuq, i cili ka një forcë fërkimi të ulët dhe për këtë arsye prish ekuilibrin e qëndrueshmërisë të shkëmbinjve karbonatik duke shkaktuar shkëputje pikërisht në këto carje. Në pjesën tjetër të Lotit 6 pasi kemi të bëjmë me shkëmbinj karbonatik të fortë të bardhë dhe gri të cilët kanë një kënd rënie në drejtim të rënies së shpatit. **Kushtet gjeologo-inxhinierike të rruges Kardhiq-Delvine loti 1.**

Loti 1 përbehet nga:

Depozitimet e Paleogenit, Oligoceni i poshtëm (Pg 3-1) i përfaqshuar nga flish alevrolitik-argjilit dhe ranor.

Depozitimet e kuaternarit. Sipas mënyrës së formimit këto depozitime do të ndahen në depozitime aluviale; depozitime proluviale dhe depozitime lagunore detare.

Depozitimet aluviale përfaqshohen nga depozitimet e lumenjve të zonës, këto depozitime përfaqshohen nga suargjila argjila lymore surera dhe rëra dhe shtresa zhavorësh. Janë depozitime pak deri mesatarisht të konsoliduara, takohen në zonën fushore dhe kanë trashësi 50-60m

Depozitimet proluviale përfaqshohen nga formimet e disa përrejtve të zonës. Në disa raste këto depozitime ndërthuren me depozitimet aluviale, përbehen nga suargjila, zhavore, rëra dhe surëra. Janë mesatarisht të konsoliduara dhe takohen në shtratin e përrejtve. Kanë trashësi 8 - 15 metra. Janë prezente në zonën ku kalon rruga e re në zonat e kodrave.

Nga vërtetimet në terren verifikohet erodimi i skarpatave të përbëra prej argjilash dhe flishe ngjyre gri, si shkak i erozionit klimatik. Bërmat ekzistuese janë dëmtuar dhe pothuajse inekzistente si në fotot e mëposhtme (foto 15, 16, 17, 18, 19), por nuk vërejmë plane rrëshkitjeje të mëdha.





Foto 15



Foto 16



Foto 17



Foto 18



Foto 19

Rekomandime

Për rivitalizim e skarpatave masat që sugjerohen për **Lotet 1-6** duke marre parasysh edhe analizat laboratorike të kryera të jenë si më poshtë:

- Rrjeta teli për mbrojtjen nga rredhja e skarptave
- System drenazhimi të ujrave sipërfaqësore
- Torkretim
- Rivitalizimin I skarpateve Hidrombjellje,gjelbërim

V.KËRKESAT PËR KONSULENTIN DHE PARAQITJA E DOKUMENTACIONIT.

5.1. Kërkesat për projekt – zbatimin.

Në këtë fazë, Konsulenti do të hartojë projektin e zbatimit i cili përfshin pregtatitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm.

5.2. Pregatitja e metodologjisë përfundimtare të punimeve të ndërtimit

Mbas përpunimit të projektit dhe hartimin e projektit përfundimtar të zbatimit Konsulenti duhet të kryejë rishikimin e metodologjisë së ndërtimit.Meqe objekti eshte ne rrugen

ek\iztuese ai duhet te perskruaja gjithë menyrene e zhvillimit te projektit pasi ai do te jete gjithmone ne trafikun e zones apo ate nacional.Duhet te pershkruaj te gjitha situatat qe mund te shfaqen apo masat qe duhet te merren. Metodollogjia e ndërtimit ndërmjët të tjerave duhet ti referohet dhe cështjeve të monumenteve të kulturës apo historike të cilave duhet ti kushtojë vëmendje kontraktori.

5.3. Volumet e punës dhe Preventivi

Bazuar në llogaritjet dhe vizatimet e projektit Konsulenti do të hartojë një listë me të gjitha zërat e punimeve që janë pjesë përbërëse e listës përfundimtare të volumeve (Preventivi). Preventivi do të shoqërohet me tabelat e volumeve dhe menyrën e llogaritjes tyre. Cmimet do të jenë ato njësi të miratuara me VKM. Një kopje të listës cmimeve njësi në rast se Konsulenti nuk arrin ta marrë nga fletoret zyrtare mund ta marrë në cdo kohë pranë A.Rr.Sh-së Zërat e punimeve që nuk janë përfshirë në listën e cmimeve njësi të miratuar Konsulenti do ti shoqëroje me analizën e llogaritjes cmimit. Preventivi do të shoqërohet me tabelën e llogaritjes së volumeve.

5.4 Përgatitja e Raportit Përfundimtar Teknik të Projektit të Zbatimit.

Raporti i projektit të zbatimit do të përfshijë të gjithë informacionin e mësipërm si dhe të reflektojë në trajtë të shkruar arsyet mbi të cilat është bazuar hartimi i detajuar i projektit. Drafti i raportit përfundimtar të projektit të zbatimit do të ketë datë dhe të jetë i firmosur dhe do të paraqitet në formë zyrtare tek A.Rr.Sh-së për shqyrtim dhe miratim.

5.5 Vizatimet

Konsulenti në fazën e projektit të zbatimit në formë grafike duhet të vizatimet e mëposhtme duke organizuar pjesën bazë të dokumentave të kontratës për zbatimin e punimeve.

- Horografia në shkallën 1: 5 000
- Planimetri e rrugës në shkallë 1:1000; 1:500; 1:200
- Profila tërthor tip SH 1:25; 1:50
- Vizatime të detajeve të ndryshme etj. SH 1: 50: 1:100.
- Detajet teknike të montimit të tabelave të sinjalistikës.
- Specifikimet teknike të materialeve që do përdoren në ndërtimin e tabelave
- Specifikimet teknike të materialeve që do përdoren në grafikën e sinjalistikës.
- Specifikimet teknike të mbrotjeve anësore dhe tjera
- Specifikime teknike të ndriçimit ku propozohet nga Konsulenti
- Detaje dhe hollesi vizatimore Shkalla1: 25, 1:50;
- Preventivin me sasi të punimeve me çmimet e Manualeve të Preventivimit në fuqi, dhe në rastet ku ato mungojnë shoqëruar me analizat përkatëse sipas metodologjisë së kërkuar në udhëzimet në fuqi.

5.6. Afati dhe mënyra e dorëzimit të projektit të zbatimit.

Mbas kthimit të draft raportit me vërtetje nga A.Rr.Sh-ja, Konsulenti do të pregatisë dhe dorëzojë në rrugë zyrtare në A.Rr.Sh-ja projektin e plotë të zbatimit së bashku me Raportin



Përfundimtar, Specifikimet teknike dhe Preventivin përfundimtar. Drafti të dorëzohet një kopje në format A-3.

Projekti do të dorëzohet në forme të shkruar në 5 (pesë) kopje të firmosura në origjinal dhe në formatet e kërkuara A-3. Raportet do të dorëzohen në format A4.

Projekti i Zbatimit do të dorëzohet në dy kopje elektronike (në disk) në formatin origjinal të punuar ose kompatibël me programet AutoCad, ArcView etj. Në menyrë elektronike do të dorëzohen dhe raportet ,preventivi dhe specifikimet teknike. Ato duhet të jenë në formatin origjinal të punuar.

Përvec kësaj Konsulenti do të pregatisë një kopje elektronike me pjesët kryesore të projektit në format PDF së bashku me raportin përfundimtar dhe specifikimet teknike. Kjo kopje elektronike (CD)do të shërbejë për tender.

IV KËRKESAT PËR KONSULENTIN DHE PARAQITJA E DOKUMENTACIONIT

Projektide do të përgatitet vetëm për segmentin e mëposhtëm

4.1 Projekt ideja për segmentin Shijan - Ura e Gajdarit (lidhja me rrugën Jergucat Sarandë)

Projekti ideja duhet të përfshijë:

- 1- Një Studim Dokumentash, i cili përfshin rishikimin e literaturës dhe grumbullimin e dosjeve të studimeve gjeologjike dhe gjeoteknike dhe interpretimin e fotografive ajrore.
- 2- Një Studim në Terren, i cili përfshin hartat gjeologjike dhe studimet e elementëve të shkëmbinjve, gjurmimit e vatrave të studimit paraprak.
- 3- Një Raport Gjeologjik e Gjeoteknik, i cili përfshin të gjitha të dhënat faktike në detaje të hollësishme dhe garanton një analizë interpretuese plotësisht të pavarur të rezultateve të studimit të tokës.

Në studimin e këtij objekti Konsulenti duhet të shqyrtojë jo më pak se dy variante (per cdo element, segmenti rrugor) por duke mos e kufizuar atë për të studiuar dhe paraqitur dhe variante apo nënvariate tjera që ai do t'i shohë të arsyeshme t'i paraqesë.

Gjatë kësaj faze konsulenti duhet që të përfshijë dhe aktivitetet e mëposhtme;

Kryerjen e vëzhgimeve që synojnë në eliminimin e hamendshmërisë të bëra gjatë fazave më të hereshme.

Përgatitjen e metodologjisë së përgjithëshme të ndërtimit.

Përgatitjen e programit të punimeve.

Përgatitjen e vlerësimit të kostos.

4.2 Ndikimet ndaj mjedisit



Projekt-ideja duhet që të paraqesë në formë të përgjithëshme zgjidhjet përfundimtare të varianteve të propozuara të projektit, tynelit, segmentit të ri . Per variantin e gjurmes ekzistuese ne lidhje me segmentin e ri duhen paraqitur mënyra për zbutjen e ndikimeve në mjedis (zhurmat, peisazhin)

4.3 Studimi Topografik.

Për këtë qëllim do të kryhet një rilevim i plotë i cili do të hartohet nga konsulenti dhe të jetë i firmosur dhe vulosur.

4.4 Studimi gjeologjik.

Ky studim do të paraqesë rezultatet egzistuese të përfituara prej mostrave të materialeve të nxjerra para fazës së projekt-idesë duke marrë parasysh dhe studimet e bëra në projekte të mëparshme.Studimi gjeologjik duhet të trajtojë të gjitha çështjet që lidhen me qëndrueshmërinë e shkëmbinjeve vecanërisht me rëndësi të vecantë duhet ti kushtohet studimit të pjese ku do të ndertohet trupi i tunelit.Studimi do të shoqërohet dhe me fotografi të cilat së bashku me hartat dhe testimet e kryera do të shërbejnë për të konfirmuar rezultatet e përfshira në studimin gjeoteknik. Studimi do të ketë datë dhe të jetë i konfirmuar nga specialisti gjeoteknik apo grupi i projektimit gjeoteknik.

4.5 Studimi Hidrologjik.

Duhet të vlerësojë kushtet hidrologjike përgjatë trupit të rrugës, nivelit të ujrave, duke përfshirë dhe studimin e drenazhimit të ujrave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë. Në përfundim të këtij studimi do të përgatitet Raporti Hidrologjik i cili do të ketë datë dhe të jetë i firmosur.

4.6 Studimi i projektimit të strukturave të veprave të artit dhe shtresave rrugore

Në këtë studim konsulenti do të mbështetet në planin prespektiv të zhvillimit të zonës duke trajtuar projektimin e shtresave rrugore për çdo seksion rrugor. Ky studim do të shtrihet për një periudhë 20-vjecare për materialet fleksibël ndërsa për ato rigjide do të shtrihet për një periudhë 50-vjecare. Ky raport do të ketë datë dhe të konfirmohet nga inxhinieri i projektimit të rrugëve apo grupi i projektimit të rrugëve.

Gjithashtu konsulenti do të ketë në konsideratë dhe shtresat rrugore të aplikuara në segmentet e përfunduara me parë që lidhen me tynelin apo dhe me segmentin e ri që do të ndertohet..

4.7 Metodologjia e Ndërtimit



Konsulenti do të përshkruajë për këtë fazë mënyrën se si do të ndërtohet vepra nga pikpamje teknike, llogjistike dhe programore në përputhje me elementët teknikë të projektit dhe rekomandimet e VNM. Këtu duhen theksuar rreziqet e vecanta në të cilat do të ndeshet Konsulenti dhe menyrat se si do të përballohen ato prej tij. Ky raport do të këtë datë dhe të firmoset nga inxhinieri i projektimit të rrugëve apo grupi i projektimit të rrugëve.

4.8 Raporti i Shpronësimeve.

Ky raport do të paraqesë një listë të mundëshme shpronësimesh për të gjithë variantet që propozohen së bashku dhe me kërkesat dhe procedurat ligjore që duhet të plotësohen në lidhje me projektin.

4.9 Kërkesat për leje apo licensa

Në këtë raport konsulenti do të raportojë për lejet apo kërkesat që klienti duhet të marrë gjatë fazave të projektimit dhe ndërtimit të objektit.

4.10 Vizatimet

Konsulenti duhet të paraqesë vizatimet e mëposhtme duke organizuar pjesën bazë të dokumentave të kontratës për zbatimin e punimeve.

- Horografia në shkallën , 1:5000, ose 1:2000. Në raste që zona e studimit është shumë e madhe duhet të përgatitet një hartë përmbledhëse në një shkallë të përshtatëshme.
- Planimetri e rrugës në shkallë 1:1000; 1:500; 1:200
- Profil gjatësor H 1:1000 V 1: 100 .
- Profila tërhor SH 1: 200; 1:100
- Profila tërthor SH 1:25; 1:50
- Harta e rlevimit topografik SH 1;1000; 1:500; 1:200
- Harta hidrollogjike SH 1:1 000
- Harta gjeollogjike SH 1:1 000; 1:500; 1:200.
- Vizatime tëveprave të artit, mbikalime,nenkalime mureve mbajtës apo pritës themelet pilat apo pilotat etj. SH 1: 50: 1:100.
- Harta të ndryshme të ndjeshmërisë mjedisore , të objekteve kulturore dhe arkeollogjike në se ka, për të gjitha variantet SH 1:1 000

4.11 Volumet e punës dhe Preventivi

Konsulenti do të përgatisë volumet e punës respektive për të gjithë kategoritë e punëve të paraqitura në projekt. Volumet do të llogariten në bazë të vizatimevë të projektit. Çmimet njësi për të gjitha punimet përkatëse do të llogariten duke pasur parasysh çmimet mesatare të miratuara me VKM dhe ato që nuk gjenden në manuale të shoqërohen me analiza teknike.



Raporti i Projekt Idesë mbasi firmoset dhe vuloet nga specialistët e firmës konsulente paraqitet tek ARRSH në formë zyrtare për shqyrtim dhe miratim. Projekt-idea do të dorëzohet në tre kopje të shkruara dhe në dy kopje në CD në formatin origjinal të punuar.

V. KËRKESAT PËR PROJEKT ZBATIMIN.

Në këtë fazë dhe mbi bazë të variantit përfundimtar të miratuar të projekt idesë nga KT i A.Rr.Sh-së, Konsulenti do të hartojë projektin e zbatimit i cili përfshin pregatitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm.

5.1 Raporti Përfundimtar i studimit te trafikut.

Raporti përfundimtar i Studimit te Trafikut do te permbledhe ne menyre te detajuar te gjitha matjet e kryera ne objekt nga vete konsulenti per periudhen qa ai ka kryer studimin, te gjitha matjet e trafikut te gjeneruarara nga ARRSH gjate viteve te kaluara, perllogaritet dhe parashikimin e trafikut per vitet e ardhshme. Raporti do te jete firmosur ne origjininal dhe i shoqeruar me te gjitha tabelat e matjeve dhe menyren e llogaritjes

5.2 Raporti Përfundimtar i studimit Topografik

Raporti përfundimtar i Studimit Topografik duhet të përmbajë të gjithë informacionin e rëndësishëm topografik i cili nevojitet gjatë fazës së hartimit të projektit të zbatimit si dhe të asaj së zbatimit të punimeve. Varianti përfundimtar dhe i miratuar i zgjidhjes së planimetrisë i përcaktuar tashmë dhe i fiksuar në harta dixhitale duhet që për këtë fazë të fiksohet edhe në terren nëpërmjet pikave kryesore të rrjetit koordinativ, te cilat duhet të kenë koordinatat dhe kuotat përkatëse. Këto pika do t'i shërbejnë ndërtuesit për piketimin përfundimtar të aksit në terren, gjithashtu të fiksohen në terren piketat

Në këtë fazë konsulenti do të paraqesë një raport të saktë të vendodhjes piketave kryesore të vendosura prej tij për zbatimin e punimeve.

Të gjitha kuotat e rrugës do të jenë absolute dhe të fiksuara në repera fikse betoni.

Në cdo rast me fillimin e punimeve nga Konsulenti fitues, konsulenti do të jetë prezent për dorëzimin e këtyre piketave.

5.3 Raporti përfundimtar i Studimit Gjeoteknik.

Konsulenti në pregatitjen e këtij raporti duhet të rishikojë edhe një herë raportin Gjeoteknik të pregatitur në variantin e projekt-idesë duke e plotësuar atë me informacione shtesë apo të dala gjatë shqyrtimit të projekt idesë në KT të A.Rr.Sh- së.

Studimi gjeologjik duhet të jetë i saktësuar duke përfshirë të gjithë dukurinë, aksin këndin dhe analizën e saktë gjeomorfollogjike të zonave rrëshqitëse nese ka.

Raporti i Studimit Gjeoteknik duhet të përpilohet për secilën dukuri fiziko-gjeologjike të trajtuar dhe për secilin nënobjekt të veprës duke përfshirë dhe materialet e ndërtimit.

Raporti i Studimit Gjeoteknik do të ketë përmbajtjen si më poshtë:



- teksti i raportit, parametrat gjeoteknik të projektimit.
- materiali grafik, harta, planimetritë, prerjet gjeologo-inxhinierike dhe në mënyrë të vecantë testimet apo shpimeve.
- fotografi ilustrative.
- konkluzionet dhe rekomandimet e grupit të studimit.

5.4 Pregatitja e metodologjisë përfundimtare të punimeve të ndërtimit

2M2b20as përpunimit të projektit dhe hartimin e projektit përfundimtar të zbatimit Konsulenti duhet të kryejë rishikimin e metodologjisë së ndërtimit. Metodologjia e ndërtimit ndërmjet të tjerave duhet ti referohet dhe çështjeve mjedisore, çështjeve të monumenteve të kulturës apo historike të cilave duhet ti kushtojë vëmendje kontraktori.

Këtu konsulenti do të japë dhe propozimin e tij për vendet e marrjes materialeve që do shërbejnë për lëndë të parë në ndërtimin e objektit cilësinë dhe specifikimet e tyre.

Në këtë fazë gjithashtu, konsulenti do të përshkruajë dhe punimet ndihmëse, nevojat e ndërtimit të rrugëve të shërbimit, te masave për devijimin e pjesës së trafikut apo tjera që dalin gjatë ndërtimit të veprës.

Konsulenti do të përshkruajë në mënyrë të vecanë dhe masat e marra për sigurinë rrugore përfshirë dhe sinjalistikën.

5.5 Raporti përfundimtar i shpronësimeve.

Konsulenti në këtë fazë do të rishikojë investigimet e kryera në fazën e projekt-idesë duke përshkruar tashmë në mënyrë të qartë dhe të hollësishme listën e pronarëve që shpronësohen, sipërfaqet e objekteve apo trojeve të bashkëngjitura me planimetritë e objekteve dhe gjatësia e trojeve, llogaritjet e sipërfaqeve si dhe vlerën e plotë të shpronësimit.

Bashkëngjitur me këto të dhëna do të jenë dhe miratimet e Zyrtare të regjistrimit të Pasurive të Palujtshme apo në mungesë të dokumenteve të pronësisë ato të ALUZNIT apo cdo miratim tjetër nga Pushteti Lokal. Kjo do të vlejë dhe për pronën shtetërore. Për këtë qëllim do të punojë ngushtë dhe me strukturat përkatëse të Bashkisë Tiranë.

5.6 Volumet e punës dhe Preventivi

Bazuar në llogaritjet dhe vizatimet e projektit Konsulenti do të hartojë një listë me të gjitha zërat e punimeve që janë pjesë përbërëse e listës përfundimtare të volumeve (Preventivi). Preventivi do të shoqërohet me tabelat e volumeve dhe menyrën e llogaritjes tyre. Cmimet do të jenë ato njësi të miratuara me VKM. Një kopje të listës cmimeve njësi në rast se Konsulenti nuk arrin ta marrë nga fletoret zyrtare mund ta marrë në cdo kohë pranë A.Rr.Sh-së Zërat e punimeve që nuk janë përfshirë në listën e cmimeve njësi të miratuar. Konsulenti do t'i shoqërojë me analizën e llogaritjes cmimit. Preventivi do të shoqërohet me tabelën e llogaritjes së volumeve.

5.7 Pregatitja e Raportit Përfundimtar Teknik të Projektit të Zbatimit.



Raporti i projektit të zbatimit do të përfshijë të gjithë informacionin e mësipërm si dhe të reflektojë në trajtë të shkruar arsyet mbi të cilat është bazuar hartimi i detajuar i projektit. Bashkëngjitur me këtë raport do të jenë në origjinal të gjitha miratimet, lejet apo propozimet e aktorëve pjesëmarrës dhe të interesuar si Pushteti Lokal, ZRPP, ALUIZNI, DPUK, KESH, ALBTELEKOM, KKA (Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë) Mjedisit, etj

Drafti i raportit përfundimtar të projektit të zbatimit do të ketë datë dhe të jetë i firmosur dhe do të paraqitet në formë zyrtare tek A.Rr.Sh-së për shqyrtim dhe miratim.

Gjithashtu duhet të Përgatiten e Specifikimet Teknike që duhet të përdoren në projekt, për të gjithë elementët e parashikuar që do të përdoren për ndërtimin e tunelit apo për të segmentet rrugore dhe sinjalistikën horizontale dhe vertikale

5.8 Vizatimet

Konsulenti në fazën e projektit të zbatimit në formë grafike duhet të vizatimet e mëposhtme duke organizuar pjesën bazë të dokumentave të kontratës për zbatimin e punimeve.

Horografia në shkallën 1: 5 000

Planimetri e hollësishme në shkallë 1:1 000; 1:500; 1:200.

Profil gjatësor H 1:1000 V 1: 100 dhe H 1:500 V 1:100.

Profila tërthor SH 1: 100; 1: 200

Profila tërthor tip SH 1:25; 1:50.

Harta e rlevimit topografik SH 1:1 000; 1:500; 1:200.

Harta hidrollogjike SH 1:1000

Harta gjeologjike SH 1:1000; 1:500; 1:200.

Vizatime e veprave të artit, detajet të vecanta themeleve prerjet të mureve mbajtes apo pritës etj SH 1: 50; 1: 100

Harta të ndryshme të ndjeshmërisë mjedisore , të objekteve kulturore dhe arkeologjike në se ka, për të gjitha variantet SH 1:1 000

Planimetritë e shpronësimeve SH 1:1000 ; 1:500.

Zonat ku do të merren materialet e ndërtimit lëndë e parë përfshirë dhe punimet e përkohëshme vendet e depozitimive etj SH 1:1000

Plani i devijimit të trafikut të përkohshëm dhe sinjalistika për këtë qëllim.

5.9 Paraqitja e Relacionit Teknik të projektit të propozuar

Ky raport duhet të përfshijë edhe këto të dhëna :

a) qëllimin e projektit të propozuar;

b) planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë;

c) informacionin për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti;

ç) skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektin, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit;



- d) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese /përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;
- e) programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit;
- ë) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);
- f) informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;
- g) informacionin për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;
- i) informacionin për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit;
- j) kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/licencimin e projektit.

5.10 Afati dhe mënyra e dorëzimit të projektit të zbatimit.

Mbas kthimit të draft raportit me vërtetje nga A.R.Sh-ja, Konsulenti do të pregatisë dhe dorëzojë në rrugë zyrtare në A.Rr.Sh-ja projektin e plotë të zbatimit së bashku me Raportin Përfundimtar, Specifikimet teknike dhe Preventivin përfundimtar. Drafti të dorëzohet një kopje në format A-3.

Projekti do të dorëzohet në forme të shkruar në 5 (pesë) kopje të firmosura në origjinal dhe në formatet e kërkuara A-3. Raportet do të dorëzohen në format A4.

Projekti i Zbatimit do të dorëzohet në tre kopje elektronike (në disk) në formatin origjinal të punuar ose kompatibël me programet AutoCad, ArcView etj. Në menyrë elektronike do të dorëzohen dhe raportet ,preventivi dhe specifikimet teknike. Ato duhet të jenë në formatin origjinal të punuar.

Përveç kësaj Konsulenti do të pregatisë një kopje elektronike me pjesët kryesore të projektit në format PDF së bashku me raportin përfundimtar dhe specifikimet teknike. Kjo kopje elektronike (CD)do të shërbejë për tender.

VI .RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

PER FAZËN E PROJEKT-ZBATIMIT konsulenti do të dorëzojë:

Raportin paraprak të VNM-së

Relacionin Teknik të projektit të propozuar

Projekti rrugor ‘Sinjalistika dhe siguria rrugore Kardhiq-Delvinë Loti 8 dhe ndërtimi i rrugëve Shijon-Ura e Gajdarit dhe rehabilitim i segmentit rrugor Shijon-Hyrje Delvinë” i nënshtrohet procedurës së vlerësimit paraprak të VNM-së, hartimi i Raportit të VNM-së dhe Relacionit Teknik duhet të bazohet në: Vendimin Nr. 686, datë 29.7.2015 ‘Për



Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Proçedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe proçedurës së Transferimit të Vendimit të Deklaratës Mjedisore”.

1. Në Raportin paraprak të VNM-së, duhet të përfshihen:

- a) përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi;
- b) informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij;
- c) informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;
- ç) një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve; (*Duhet të identifikohen venddepozitimet për mbetjet e ngurta të autorizuar nga pushteti vendor.*)
- d) informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;
- dh) të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;
- e) mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;
- ë) masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;
- f) ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).

2. Në Relacioni Teknik të projektit të propozuar, duhet të përfshihen:

- a) qëllimin e projektit të propozuar;
- b) planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë;
- c) informacionin për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti;
- ç) skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektin, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit;
- d) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese /përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;
- dh) informacionin për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;
- e) programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit;
- ë) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);



- f) informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;
- g) informacionin për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;
- gj) të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasinë e ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;
- h) aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.;
- i) informacionin për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit;
- j) kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/licencimin e projektit.

Përlllogaritja e tarifës

Bazuar në Ligjit 10440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca II: Projektet që i nënshtrohen procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis, pika 10. Prodhime infrastrukturore: d) Ndërtim rrugësh, portesh dhe instalimesh për porte, duke përfshirë dhe portet e peshkimit (projekte që nuk përfshihen në shtojcën I), dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.5.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”:

Projekti rrugor rrugor ‘Sinjalistika dhe siguria rrugore Kardhiq-Delvinë Loti 8 dhe ndërtimi i rrugëve Shijon-Ura e Gajdarit dhe rehabilitim I segmentit rrugor Shijon-Hyrje Delvinë’ i nënshtrohet procedurës së vlerësimit paraprak të VNM-së, në bazë të nenit 76 përfshihet në:

1. Grupi II Tarifor

2. Sipërfaqja në hektar

Raporti paraprak i VNM-së dhe Relacioni Teknik të jetë i nënshkruar nga personi fizik/juridik i licencuar. Si dhe te këtë aktin e regjistrimit të personit fizik/juridik, sipas legjislacionit në fuqi.

Për fazën e ndërtimit Konsulenti duhet të pajiset me lejet si më poshtë:

Vendimin për VNM PARAPRAKE, bazuar në ligjin nr. 10440, date 07.07.2011” PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS” (VNM-së) të ndryshuar, dhe VKM nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”

Vendimin nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë bazuar në Ligjin nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” dhe aplikimi pranë Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik **Vendimin nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve,** bazuar të ligjit nr. 27/2018, ”Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” dhe aplikimi pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës

Heqja nga fondi pyjor, bazuar në VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe



të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar:

Leja e Infrastrukturës bazuar në ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 ‘‘Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit’’ i ndryshuar dhe në Vendimin Nr. 408, datë 13.05.2015 dhe aplikimi pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit.

Miratimi nga pushteti vendor për venddepozitimet për mbetjet e ngurta.

8. FAZAT, AFATET DHE MIRATIMET

8.1 Fazat

Fazat e parashikuara dhe afatet orientuese për ndertimin e objekteve janë :

Projekti

Projekt idea për rrugën lidhëse Shijon – Ura e Gajdarit 1 muaj

Projekti i zbatimit për të gjithë objektet (përfshirë dhe afatin e opionencës) 3 muaj

Te gjitha fazat do të kontrollohen dhe miratohen nga ARrSh.

Konsulenti në fund të çdo faze duhet të paraqesë këto raporte :

Raportet e projektimit (të detajuara sipas proceseve)

Raport të detajuara të ecurisë punimeve

Raportin teknik (të detajuara sipas proceseve, topografik, gjeologjik, hidrollogjik gjeoteknik etj)

Raportin e menaxhimit të riskut

Raportin e Monitorimit

Konsulenti për marrjen e lejes së ndërtimit duhet të plotësojë dhe këto dokumente:

Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e Lejeve Mjedisore, bazuar në ligjin Nr. 10440, datë 07.07.2011 "PËR VLERESIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS" (VNM-së) të ndryshuar, dhe VKM nr. 686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklarates mjedisore" për objektet që do të ndërtohen.

- Mendimi nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura përpara miratimit të projektit zbatimit nga Këshilli Teknik i Arrsh-së.
- Përcaktimi i venddepozitimit të interteve nga Njësi e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV)
- Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm në bazë të ligjit Nr. 27/2018, "Për Trashegiminë Kulturore dhe Muzetë" dhe aplikimi pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës për Vendimin nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve për objektin që do të ndërtohen përpara miratimit të projektit zbatimit nga Këshilli Teknik i Arrsh-së. Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm bazuar në ligjin Nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar dhe në Vendimin Nr. 408, datë 13.05.2015 për aplikimin e Lejes së infrastrukturës



nga A.Rr.Sh .

- Përgatitja e dokumentacionit për heqjen nga fondi pyjor në mbeshtetje të VKM nr. 1353, datë 10. 10.2008 "Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vellimit të fondit pyjor", i ndryshuar , si dhe të VKM nr.1374, date 1ë. 1 0.2008 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor",
- Përgatitja e vëzhgimi arkeologjik per Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik bazuar në ligjin Nr.9048, datë 07.04.2003 "PËR TRASHËGIMINË KULTURORE" i ndryshuar .
- Përgatitja e dokumentacionit të nevojshem për kërkesën "Për përdorim te burimeve ujore për veprimtari ndërtimore ne brigje", Bazuar në Ligjin Nr. 111/2012 datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.416, datë 13.5.2015 "Per miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatin e vlefshmërisë, formulareve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes.

